



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 491/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Vllastimir Dimic dhe Ferid Osmani, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjekteve politike Bosnjacka Stranka Demokratske Akcje Kosova (BSDAK), Stranka Demokracka Akcje (SDA), Nova Demokracka Stranka (NDS) dhe Social Demokracka Starnka Gore (SDSG) me seli në Dragash, paraqitur kundër anëtareve KKZ-se Dragash, përkatësisht anëtare te koalicionit politik VAKAT, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e subjekteve politike Bosnjacka Stranka Demokratske Akcje Kosova (BSDAK), Stranka Demokracka Akcje (SDA), Nova Demokracka Stranka (NDS) dhe Social Demokracka Starnka Gore (SDSG), përkatësisht me numër të lëndës A491, A492, A493 dhe A494, të datës 12.12.2010.

Arsyetim

Me date 12.12.2010, PZAP ka pranuar 4 (katër) ankesa, me numër te lendes 491, 492, 493 dhe 494, nga subjektet politike BSDAK, SDA , NDS dhe SDSG, ne te cilën pretendohet se anëtarët e koalicionit politik VAKAT, përkatësisht anëtare te KKZ-se Dragash, ka përfshirë ne rezultatin zgjedhor ne komunën e Dragashit një numër te madh fletëvotimesh te parregullta, duke manipuluar rezultatin zgjedhor ne komunën ne fjale. Gjithashtu parashtruesit e ankesave theksojnë se vëzhguesit e tyre nuk kane pasur mundësi qe te punojnë si duhet gjate ditës se zgjedhjeve si dhe RTV21 ka deklaruar se subjekti VAKAT ka dashur te “fut brenda adoleshente te pajisur me letërnjoftime te huaja”. Për këto arsye parashtruesit e ankesave kërkojnë t’ju jepet e drejta për ti përsëritur zgjedhjet ne Restetelice-komuna e Dragashit.

Ne mbështetje te pretendimeve, parashtruesit e ankesave nuk kane bashkangjitur asnjë prove.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) dhe neni 6.3 parashohin si vijon:

3.6 (c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

6.3. Me qellim të lehtësimit të shyrtimit të ankesave, kryesuesi i panelit mund të vendose ta bej bashkimin e ankesave që perbajne ne vete çeshtje te ngjashme, paneli vendimmarrës i trajton ato si kur te ishin një ankese.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi te gjitha shkresat e lendes gjeti se:

- ankesat janë të pabazuara

Nga shkresat e lendes PZAP vlerëson se ankesat e subjekteve politike BSDAK, SDA , NDS dhe SDSG, ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur parregullsi gjatë votimit si dhe nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullësin e pretenduar. Për këto arsye, dhe duke u bazuar ne dispozitat e lartpërmendura si dhe ne kuptimin e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 491/2010 më datën 14.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj**



[Handwritten signature in blue ink]